



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM**  
**TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**  
**Drejtoria Rajonale Berat**



Lagjia "30Vjetori", Berat Tel/Fax. +355 32 23 4001, e-mail: [berat@fsdksh.com.al](mailto:berat@fsdksh.com.al), [www.fsdksh.com.al](http://www.fsdksh.com.al)

## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Berat shpall vend të lirë pune për:

### **1 (një) Specialist Ekonomist në Sektorin e Rimbursimit pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Berat.**

Kerkesat e pergjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Berat janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Ekonomisë;
- Të jetë i komunikueshëm dhe të ketë aftësitë punës në grup;
- Të zotërojë kompjuterin;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh (preferohet anglisht);
- Nota mesatare do të jetë avantazh;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale Berat, **brenda datës 28 Prill 2017**, si më poshtë vijon:

- Kërkesë për punësim.
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale (curriculum vitae).
- Diplomë e noterizuar.
- Diplomë Master e noterizuar.
- Listë notash e noterizuar.
- Çertifikatë kompjuteri.
- Çertifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme.

- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar.
- Librezën e punës.
- Fotokopje e kartës së indentitetit.
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit).
- Çertifikatë Familjare.
- Raport mjekësor për aftësi në punë.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet. Të interesuarit të paraqesin dokumentat pranë DRFSDKSH Berat, brenda afatit të mësipërm.

**Adresa:**

**Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Berat,**

**Lagjia “30 Vjetori”, Berat.**